



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË
PËR KRIME TË RËNDA

NR. AKTI 23
13.09.2018

NR. VENDIMI 20
15.09.2018

VENDIM

“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, e përbërë nga:

GJYQTARE: IRENA GJOKA

Asistuar nga sekretare seance **Blerta Martini**, sot në datë **15.09.2018, ora 11:00**, mori në shqyrtim, në dhomë këshillimi, kërkesën penale Nr.23 Regjistri, me palë:

KËRKUES: Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, përfaqësuar në paraqitjen e kërkesës nga prokurorët, Gentjan Osmani, Besim Hajdarmataj, Arens Çela, Dritan Prençi dhe Vladimir Mara.

OBJEKTI: Vendosjen e masës së sekuestrimit të pasurisë.

KUNDËR: **1.M. H.**, i biri i C. dhe i Z., i datëlindjes xxxx, lindur dhe banues në xxxx.

2. **A. H.**, i biri i C. dhe i Z., i datëlindjes xxxx, lindur dhe banues në xxxxxx

3. **F. H.**, i biri i C. dhe i Z., i datëlindjes xxxx, lindur dhe banues në xxxx

BAZA LIGJORE; Nenet 3-7, 11, 12, 14 dhe 15 ligjit nr.10192, datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” i ndyshuar me ligjin Nr.70 viti 2017.

Gjykata, pasi shqyrtoi kërkesën dhe aktet e paraqitura, në dhomë këshillimi, bazuar në nenet 112 të Kodit Penal, nenet 3/1/c;3/4; 5; 7; 11/1/a, 12, 14, 15 e vijues te ligjit Nr.10192, datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” i ndyshuar me ligjin Nr.70 viti 2017:Si dhe pasi e vlerësoi kërkesën në tërësi;

VËREN SE:

Më datë xxxx, në sekretarinë e kësaj Gjykate është depozituar për gjykim

kërkesa, me kërkuar Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë me objekt, Sekuestrimi i pasurisë në zotërim të shtetasve, **M. H., A. H. dhe F. H.** .

Në përputhje me kërkesat e nenit 12 paragrafi i parë të ligjit nr.10192, datë 03.12.2009, i ndryshuar me ligjin Nr.70 viti 2017, kjo gjykatë në dhomë këshillimi, brenda afatit 5 ditor mori në shqyrtim kërkesën e prokurorit.

Rrethanat e çështjes dhe provat e paraqitura nga prokuroria në mbështetje të kërkesës për sekuestrim

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, me datë xxxx ka regjistruar procedimin penal Nr.xxxx për veprën penale “Kultivimi i bimëve narkotike”, “ Grupi i strukturuar kriminal”, të parashikuara nga nenet 284, 333/a të Kodit Penal. Nga të dhënat e gumbulluar rezultoi se disa persona, shtetas shqiptar ushtronin veprimtarinë e kundraligjshme të kultivimit të bimëve narkotike duke vepruar si grup i strukturuar kriminal.

Me datë xxxx, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë ka regjistruar procedimin penal Nr.xxxx për veprën penale “Trafikimi i narkotikëve”, në bashkëpunim, parashikuara nga neni 283/a/2 i Kodit Penal. Nga të dhënat e grumbulluara rezultoi se shtetasit N. S., M. H., F. H., M. M. ushtronin aktivitet kriminal të trafikimit të lëndëve narkotike nga Shqipëria në drejtim të Italisë.

Me datë xxxx është vendosur bashkimi i procedimeve penale Nr.xxxx të vitit xxxx me procedimin penal nr. xxxx të vitit xxxx në një procedim penal Nr.xxxx të vitit xxxx.

Nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë, në kuadër të materialit pasuror Nr.xxxx datë xxxx, janë kryer verifikimet pasurore në ngarkim të shtetasve **M. H.**, i biri i C. dhe i Z., i datëlindjes xxxx, lindur dhe banues në xxxx; **A. H.**, i biri i C. dhe i Z., i datëlindjes xxxx, lindur dhe banues në xxxx,xxxx; **F. H.**, i biri i C. dhe i Z., i datëlindjes xxxx, lindur dhe banues në xxxx;

Në kuadër të verifikimeve pasurore, i është kërkuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë xxxx, kopje e fashikullit të procedimit penal nr.xxxx të vitit xxxx, për veprën penale të “*Pastrimit të produkteve të veprës penale*” parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal. Me shkresën me nr. xxxx Prot.A.XH. të datës xxxx, është dërguar gjithë dokumentacioni i administruar në kuadër të procedimit penal nr.xxxx të vitit xxxx. Në vijim të hetimeve nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë xxxx, ka rezultuar se është bërë kërkesë për vendosjen e sekuestros preventive mbi pasuritë e paluajtshme të shtetasve M. H., A. H. dhe F. H. dhe familjarëve të tyre.

Gjykata e Shkallës së Parë xxxx ka vendosur me vendimin Nr.xxxx datë xxxx pranimin e kërkesës dhe vendosjen e masës të sekuestros preventive mbi pasuritë e paluajtshme të regjistruara në Z.V.R.P.P.xxxx në emër të shtetasve M. H., A. H. dhe F. H. dhe konkretisht :

– Pasuria xxxx, Z.K.xxxx, vol.xxx fq.xxx, e llojit njësi me sipërfaqe totale xxxx m., e ndodhur në lagjen “xxxx”, xxxx, e cila figuron në pronësi të shoqërisë “xxxx” sh.a.;

– Pasuria xxxx, Z.K.xxxx, vol.xx fq.xxx, e llojit njësi me sipërfaqe totale xxxx m., e ndodhur në lagjen “xxxx”, xxxx, e cila figuron në pronësi të

shtetasit F. H.;

– Pasuria xxxx, Z.K.xxxx, vol.xx fq.xx, e llojit apartament me sipërfaqe totale xxxx m², e cila figuron në pronësi të shtetasit A. H.;

– Pasuria me sipërfaqe xx m², apartament banimi në lagjen “xxxx”, xxxx, ndërtuar nga shoqëria “xxxx” sh.p.k. kontraktuar nga shtetasja K. H. në datë xxxx.

– Pasuria nr.xxxx, me sipërfaqe xxxx m², e ndodhur në xxxx, Z.K.xxxx, vol.xx, fq.xx, në pronësi të shtetasit F. M.;

– Pasuria xxxx Z.K. xxxx, vol.xxx fq.xx, e llojit ndërtesë me sipërfaqe xxxx m², e ndodhur në lagjen “xxxx”, xxxx, e cila figuron në pronësi të shtetasit A. H.;

Me shkresën nr.xxxx prot. (P.H.) datë xxxx të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë xxxx, ka rezultuar se është regjistruar procedimi penal Nr.xxxx i vitit xxxx, në ngarkim të shtetasit **M. H.**, i cili është marrë si i pandehur nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë xxxx për kryerjen e veprës penale të “*Prodhimit dhe shitjes së narkotikëve e kryer në bashkëpunim*”parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal dhe i hetuar me masë sigurimi “Arrest me burg”.

Në kuadër të këtij hetimi pasuror dhe në funksion të një hetimi të plotë e të gjithanshëm, nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, i është kërkuar informacion të gjitha bankave, Bankës së Shqipërisë, Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor, Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Zyrës Kombëtare të Punësimit, dhe Zyrës së Përgjithshme të Pasurive të Paluajtshme dhe nga institucionet e mësipërme është administruar dokumentacionin si më poshtë:

– Me shkresën nr.xxxx prot. datë xxxx të Bankës së Shqipërisë nuk ka rezultuar që deri në datë xxxx shtetasve M. H., A. H. dhe F. H. apo familjarët e tyre të kenë hapur llogari cash/titujsh për blerjen e bonove të thesarit të shtetit shqiptar, pranë Bankës së Shqipërisë.

– Përsa i përket informacionit të administruar nga bankat ka rezultuar se shtetasit M. H., A. H. dhe F. H. apo familjarët e tyre kanë llogari të hapura dhe të mbyllura në banka të ndryshme por nuk figurojnë depozita apo llogari me shuma të konsiderueshme në emër të këtyre shtetasve apo familjarëve të tyre.

– Nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve me shkresën nr.xxxx prot. datë xxxx si dhe nga kërkimet në QKB, ka rezultuar se shtetasi A. C. H. ka të regjistruar subjektin “xxxx” sh.p.k. me nipt xxxx me objekt: Tregti me shumicë e pakicë,hotel, restorant, bar-bufë piceri, tregti karburantesh etj. Po kështu figuron ortak i vetëm me pjesëmarrje 100% i subjektit dhe administrator. Për shtetasi F. C. H., në sistemin tatimor xxxx figuron subjekti F. H. me nipt xxxx, me objekt Bar-Kafe.

- Nga kontrolli në Arkivën Kombëtare të Regjistrimit të Mjeteve në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, sipas shkresës Nr.xxxx prot. datë xxx, rezulton se figurojnë në pronësi të familjarëve të shtetasve M. H., A. H., F. H. dhe të familjarëve të tyre, mjetet si më poshtë: Shtetasi A. C. H. ka në pronësi mjetin me targë xxxx, e markës xxxx, modeli xxxx, e vitit të prodhimit xxxx; Shtetasi F. C. H., ka në pronësi mjetet me targa xxxx, e markës xxxx, e vitit të prodhimit xxxx, xxxx, e markës xxxx, e vitit të prodhimit xxxx, xxxx, e markës xxxx, e vitit të prodhimit xxxx dhe xxxx, e markës xxxx, e vitit të prodhimit xxxx;

- Nga verifikimet e kryera pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave sipas shkresës nr.xxxx prot. datë xxxxx, ka rezultuar se shtetasit, M. dhe A. H., kanë të regjistruar nga një deklaratë doganore importi. Shtetasi M. H. ka importuar Agregate, konstruksione nga Gjermani në vlerën xxxx euro dhe shtetasi A. H. ka importuar mermer, travertin dhe alabastër nga Reggio Calabria, Itali në vlerën xxxx euro.

- Gjithashtu nga informacioni i administruar nga Institutit të Sigurimeve Shoqërore me shkresën nr.xxxx prot. datë xxxx, ka rezultuar se nga këta shtetas dhe familjarët e tyre janë të siguruar në aktivitetet private shtetasit, A. H., K. H. dhe F. H. dhe nga Zyra Kombëtare e Punësimit ka rezultuar se këta shtetas nuk figurojnë si punëkërkuës.

- Nga verifikimet e kryera pranë O.Sh.E.E. sipas shkresës Nr.xxxx prot. datë xxxx, ka rezultuar se vetëm shtetasit Z. H., A. H. dhe K. H. figurojnë me nga një kontratë furnizimi secili.

Nga verifikimet e bëra nga sistemi online i aplikimeve të ndërtimeve informale pranë Aluizni-t xxxx, rezulton se:

Shtetasi A. C. H. ka aplikuar për legalizimin e një objekti sipas kërkesës me nr.xxxx datë xxxx, me nr.xxxx prot. datë xxxx, me nr.xxxx prot. datë xxxx.

-Shtetasi M. C. H. ka aplikuar për legalizimin e një objekti sipas kërkesës nr.xxx datë xxxx me vendodhje xxxx, ndërtesë x kat me sipërfaqe trualli xxxx m., kërkesës nr.xxxx prot. datë xxxxx dhe nr.xxxx prot. datë xxxx.

-Shtetasi F. C. H., ka aplikuar për legalizimin e një objekti sipas kërkesës nr.xxxx prot. datë xxxx, me nr.xxxx prot. datë xxxx, me nr.xxxx prot. datë xxxx dhe nr.xxxx prot. datë xxxx.

Përsa i përket pasurive të paluajtshme nga informacioni i administruar nga Z.R.P.P. e rretheve rezultoi se shtetasit M. H., A. H. dhe F. H. dhe familjarët e tyre kanë pasuri të regjistruara vetëm në Z.V.R.P.P.xxxx. Nga verifikimet e kryera, pranë Z.V.P.P. datë xxxx, janë marrë kartelat e pasurive së bashku me praktikat e fitimit të pronësisë të pasurive të paluajtshme të shtetasve M. H., A. H., F. H. dhe familjarëve të tyre për pasuritë e paluajtshme si më poshtë:

- Pasuria xxxx Z.K. xxxx, vol.xx fq.xx, e llojit ndërtesë me sipërfaqe xxx m., e cila figuron në pronësi të shtetasit A. H., i cili e ka blerë me kontratën e shitjes Nr.xxxx Rep dhe xxxx Kol. datë xxxx, me vlerë xxxx euro.

- Pasuria xxxx, Z.K.xxxx, vol.xx fq.xx, e llojit garazh me sipërfaqe totale

xxx m₂, e cila figuron në pronësi të shtetasit A. H., i cili e ka blerë me kontratën e shitjes Nr.xxxx Rep dhe xxxx Kol. datë xxxx, me vlerë xxxx euro

- Pasurinë xxxx, Z.K.xxxx, vol.xx fq.xx, e llojit apartament me sipërfaqe totale xxxx m₂, e cila figuron në pronësi të shtetasit A. H., me kontratën e shitjes Nr.xxxx Rep dhe Nr.xxxx Kol. datë xxxx, me vlerë xxxx (xxxx) lekë.
- Pasurina xxxx, Z.K.xxxx, vol.xx fq.xx, e llojit apartament me sipërfaqe totale xxxx m₂, e cila figuron në pronësi të shtetasit C. H., i cili e ka blerë me kontratën e shitjes Nr.xxxx Rep dhe Nr.xxxx Kol. datë xxxx, me vlerë xxxx (xxxx) lekë.
- Pasurinë xxxx, Z.K.xxxx, vol.xx fq.xx, e llojit apartament me sipërfaqe totale xxxx m₂, e cila figuron në pronësi të shtetasit C. H., i cili e ka blerë me kontratën e shitjes Nr.xxxx Rep dhe Nr.xxxx Kol. datë xxxx, me vlerë xxxx (xxxx) lekë.
- Pasurinë xxxx, Z.K.xxxx, vol.xx fq.xx, e llojit apartament me sipërfaqe totale xxxx m₂, e cila figuron në pronësi të shtetasit M. H., i cili e ka blerë me kontratën e shitjes Nr.xxxx Rep dhe Nr.xxxx Kol. datë xxxx, me vlerë xxxx (xxxx) lekë.
- Pasuria xxxx, Z.K.xxxx, vol.xx fq.xx, e llojit apartament me sipërfaqe totale xxxx m₂, e cila figuron në pronësi të shtetasit A., M. dhe F. H., të cilët e kanë blerë me kontratën e shitjes Nr.xxxx Rep dhe Nr.xxxx Kol. datë xxxx, me vlerë xxxx (xxxx) lekë.
- Pasurinë xxxx, Z.K.xxxx, vol.xx fq.xx, e llojit truall me sipërfaqe totale xxxx m₂, e cila figuron në pronësi të shtetasit A., M. dhe F. H., të cilët e kanë blerë me kontratën e shitjes Nr.xxx Rep dhe Nr.xxx Kol. datë xxxx, me vlerë xxxx euro.
- Pasurinë xxxx, Z.K.xxxx, vol.xx fq.xx, e llojit ndërtesë me sipërfaqe totale xx m₂, e cila figuron në pronësi të shtetasit A., M. dhe F. H., të cilët e kanë blerë me kontratën e shitjes Nr.xxxx Rep dhe Nr.xxx Kol. datë xxxx, me vlerë xxxx euro.
- Pasurinë xxxx, Z.K.xxxx, vol.xx fq.xxxx, e llojit njësi me sipërfaqe totale xxxx m₂, e cila figuron në pronësi të shtetasit F. H.; i cili e ka blerë me kontratën e shitjes Nr.xxx Rep dhe xxx Kol. datë xxxx, me vlerë xxxx euro.
- Pasuria xxxx, Z.K.xxxx, vol.xx fq.xx, e llojit njësi me sipërfaqe totale xxx m₂, e cila figuron në pronësi të shoqërisë “xxxx” sh.a.;
- Pasurinë xxxx, Z.K.xxxx, vol.xx fq.xxx, e llojit apartament me sipërfaqe totale xxxx m₂, e cila figuron në pronësi të shtetasit Z. H., e cila e ka blerë me kontratën e shitjes Nr.xxx Rep dhe xxx Kol. datë xxxx, me vlerë xxxx (xxxxx) lekë.
- Një apartament me sipërfaqe xx m₂, ndodhur në lagjen “xxxx”, xxxx, me vlerë xxxx euro. Nga dokumentacion i administruar rezulton se shtetasja K. H. (bashkëshortja e shtetasit A. H.), me kontratë paraprake shitje Nr.xxx Rep dhe Nr.xxx Kol. datë xxxx, ka blerë nga shoqëria “xxxx” sh.p.k.
- Pasuria xxxx, Z.K.xxxx, vol.xxx fq.xx, e llojit apartament, me sipërfaqe xxxx m₂, e cila figuron në pronësi të shtetasit F. M., i cili e ka blerë me kontratën e shitjes Nr.xxx Rep dhe xxxx Kol. datë xxxx, me vlerë xxxx (xxxx) lekë.

Nga kqyrja e regjistrave, kjo pasuri nuk figuron e regjistruar në sistemin e regjistrimit në Z.V.R.P.P.xxxx.Po kështu nga kqyrja e regjistrave në Z.V.R.P.P.xxxx

nuk figuron asnjë pasuri e regjistruar në sistemin e regjistrimit në emër të shoqërisë “xxxx” sh.p.k.

Përsa i përket pasurive të luajtshme, nga verifikimet përkatëse ka rezultuar se në favor të shtetasit A. C. H., figurojnë konkretisht; Automjeti me targë xxxx, e markës xxxx, modeli xxx, e vitit të prodhimit xxxx; Në favor të shtetasit F. C. H., figurojnë konkretisht; Automjeti me targa -xxxx, e markës xxxx, e vitit të prodhimit xxxx Automjeti me targa -xxxx, e markës xxxx, e vitit të prodhimit xxxx Automjeti me targa -xxxx, e markës xxxx, e vitit të prodhimit xxxx Automjeti me targa -xxxx, e markës xxxx, e vitit të prodhimit xxxx

Pala kërkuese, nisur nga rrethanat e mësipërme, ka parashtruar se nga analiza fakteve dhe e dokumentacionit të administruar përsa i përket pasurive të shtetasve M. H., A. H., F. H. dhe familjarëve të tyre, rezulton se kanë një nivel të pajustificuar ekonomik dhe dyshohet se këto pasuri të paluajtshme apo të paluajtshme, ti kenë fituar si rezultat i veprimtarisë së tyre kriminale që ata kanë zhvilluar në Shqipëri dhe në Itali. Pasuritë e shtetasve M. H., A. H., F. H. dhe familjarëve të tyre, dyshohet se janë vendosur nga të ardhurat e krijuara nga aktiviteti kriminal dhe bazuar në nenin 11 të ligjit Nr.10192 datë 03.12.2009 “Për Parandalimin dhe Goditjen e Krimin të Organizuar, Trafikimit dhe Korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” duhet të vendoset sekuestro mbi këto pasuri për sa më poshtë:

Së pari, pasuritë e mësipërme janë pasuri që plotësojnë kriteret e parashikuara nga neni 11 i ligjit nr.10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimin të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, pasi ekziston dyshimi i arsyeshëm se shtetasit në fjalë janë përfshirë në veprimtarinë kriminale të veprës penale “Trafikimi i narkotikëve”, në bashkëpunim, parashikuara nga neni 283/a/2 i Kodit Penal dhe se pasuria në fjalë është krijuar gjatë përshtirjes së shtetasit të mësipërm në veprimtarinë kriminale të mësipërme.

Së dyti, pasuritë e mësipërme, zotërohen nga shtetasit e sipërmendur si subjekt të ligjit dhe ekzistojnë prova konkrete se janë të pajustificuara. Duke u krahasuar vlera e tyre me të ardhurat e fituara në rrugë të ligjshme, rezulton se vlera e tyre nuk iu përgjigjet dukshëm nivelit të të ardhurave dhe të fitimeve të realizuara në rrugë të ligjshme.

Së treti, ka arsye të bazuara për të besuar se lidhur me pasurinë e mësipërme ekziston rreziku real për humbjen, për marrjen apo për transferimin e saj tek persona të tjerë, me qëllim për të bërë të pamundur konfiskimin e kësaj pasurie. Për këto arsye, në bazë të neneve 3-7, 11, 12, 14 dhe 15 të ligjit nr.10192, datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimin të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” kërkoi sekuestrimin e pasurive përmendur më sipër.

Vlerësimi i Gjykatës

Kjo gjykatë në analizë të akteve dhe provave të mësipërme, si dhe në vështrim të parashikimeve të neneve 3¹, 5, 6 e posaçërisht kriteret e përcaktuara në nenin 11²-12 të ligjit parandalues Nr.10192 datë 03/12/2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimin të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” i ndryshuar me ligjin Nr.70/2017 vlerëson se, kërkesa është e bazuar në ligj dhe në prova e si e

tillë duhet të pranohet.

Së pari: Gjykata arrin në konkluzion se, në bazë të nenit 3/1/ gërma "c" e ligjit Nr.10192 datë 03.12.2009 i ndryshuar, të hetuarit **M. H., A. H. dhe F. H.**, në këtë procedim pasuror janë subjekte të ligjit parandalues pasi **ekziston një dyshim i arsyeshëm, i bazuar në indicie, që tregon se personat e mësipërm janë të përfshirë në veprimtari kriminale** të "Trafikimi i narkotikëve", në bashkëpunim, parashikuara nga neni 283/a/2 i Kodit Penal, që në bazë të nenit 3/1, gërmat "c" të ligjit nr.10192, datë 03.12.2009 i ndryshuar, **kjo veprë përfshihen në fushën e zbatimit të ligjit** dhe zotërojnë pasuri dukshëm shpërpjesëtimore në raport me nivelin e të ardhurave apo fitimeve nga veprimtari të ligjshme të rregjistruara dhe që nuk përlligjen prej tyre.

Së dyti: Po ashtu ekzistojnë të paktën një prej kushteve të pikës 1 të nenit 11 të ligjit më sipër (neni 11/1 gërma a) pasi ka arsye të bazuara për të besuar se lidhur me pasuritë e luajtshme dhe paluajtshme të mësipërm ekziston rreziku real për humbjen, për marrjen apo për transferimin e tyre tek persona të tretë, me qëllim për të bërë të pamundur konfiskimin e tyre. Në analizë sa sipër, mbi bazën e provave të marra e shqyrtuara në dhomë këshillimi, gjykata vlerëson se kërkesa e palës kërkuese për sekuestrimin e pasurive të evidentuara në pronësi të të hetuarve, **M. H., A. H. dhe F. H.**, është e përlligjur e duhet të pranohet.

Në bazë të nenit 12/2 të ligjit të sipercituar masa e sekuestros është e ekzekutueshme me shpalljen e saj dhe është e vlefshme për një periudhë 6 mujore. Në bazë të nenit 14/1 urdhërohet sekretaria gjyqësore të dërgojë pa vonesë dy kopje të vendimit, prokurorëve të cilët duhet të marrin masat për vënien në ekzekutim të vendimit nëpërmjet oficerit të policisë gjyqësore dhe administratorit të pasurive.

Mbështetur në nenin 14/3 të ligjit Nr.10192 datë 03.09.2009, i ndryshuar, policia gjyqësore pas udhrit të ekzekutimit të lëshuar nga prokurori, proçedon me marrjen e pasurisë dhe dorëzimin tek administratori i pasurisë.

Referuar nenit 14/4 e ligjit më sipër, policia gjyqësore u njofton masën e sekuestrimit të pasurive personave të interesuar, që kanë në zotërim apo pronësi pasuritë objekt sekuestrimi.

Në referim të nenit 15/1 të ligjit sipercituar për administrimin e kesaj pasurie te ngarkohet Z.A. B. dhe E. R., administrator pranë Agjencisë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara në Ministrinë e Financave, Tiranë.

Referuar nenit 5 paragrafi i 3 të ligjit Nr.10192 datë 03.09.2009, i ndryshuar me ligjin Nr.70/2017, Gjykata urdhëron pezullimin e pasojave të zbatimit të masës së sekuestrimit, për pasuritë e sekuestruara sipas dispozitave të Kodit Penal dhe të Kodit të Procedurës Penale, me vendimin Nr.xxx datë xxxx,të Gjykatës së Shkallës së Parë xxxx, deri në dhënien e një vendimi gjyqësor penal për revokimin apo shuarjen e kesaj mase.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata në bazë të neneve 112 të K.Pr.Penale, nenet 3/1/c; 3/4; 5; 7; 11/1/a, 12,14,15 e vijues të ligjit Nr.10192 datë 03.12.2009 "Për parandalimin dhe goditjen e kimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë" i ndryshuar me ligjin Nr.70/2017

VENDOSI

I. Pranimin e kërkesës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë.

II. Sekuestrimin e pasurive të mëposhtme:

1. Pasuria xxxx Z.K. xxxx, vol.xxx fq.xxx, e llojit ndërtesë me sipërfaqe xxxx m., e cila figuron në pronësi të shtetasit A. H., i cili e ka blerë me kontratën e shitjes Nr.xxxx Rep dhe xxxx Kol. datë xxxx, me vlerë xxxx euro.
2. Pasuria xxxx, Z.K.xxxx, vol.xx fq.xx, e llojit garazh me sipërfaqe totale xxxx m., e cila figuron në pronësi të shtetasit A. H., i cili e ka blerë me kontratën e shitjes Nr.xxxx Rep dhe xxxx Kol. datë xxxx, me vlerë xxxx euro
3. Pasurinë xxxx, Z.K.xxxx, vol.xx fq.xx, e llojit apartament me sipërfaqe totale xxxx m., e cila figuron në pronësi të shtetasit A. H., me kontratën e shitjes Nr.xxxx Rep dhe Nr.xxxx Kol. datë xxxxx, me vlerë xxxxx (xxxx) lekë.
4. Pasurina xxxx, Z.K.xxxx, vol.xx fq.xx, e llojit apartament me sipërfaqe totale xxxx m., e cila figuron në pronësi të shtetasit C. H., i cili e ka blerë me kontratën e shitjes Nr.xxxx Rep dhe Nr.xxxx Kol. datë xxxx, me vlerë xxxx (xxxx) lekë.
5. Pasurinë xxxx, Z.K.xxxx, vol.xx fq.xx, e llojit apartament me sipërfaqe totale xxx m., e cila figuron në pronësi të shtetasit C. H., i cili e ka blerë me kontratën e shitjes Nr.xxxx Rep dhe Nr.xxxx Kol. datë xxxx, me vlerë xxxx (xxxx) lekë.
6. Pasurinë xxxx, Z.K.xxxx, vol.xx fq.xx, e llojit apartament me sipërfaqe totale xxx m., e cila figuron në pronësi të shtetasit M. H., i cili e ka blerë me kontratën e shitjes Nr.xxxx Rep dhe Nr.xxxx Kol. datë xxxx, me vlerë xxxx (xxxx) lekë.
7. Pasuria xxxx, Z.K.xxxx, vol.xx fq.x, e llojit apartament me sipërfaqe totale xxx m., e cila figuron në pronësi të shtetasit A., M. dhe F. H., të cilët e kanë blerë me kontratën e shitjes Nr.xxxx Rep dhe Nr.xxxx Kol. datë xxxx, me vlerë xxxxx (xxxx) lekë.
8. Pasurinë xxxx, Z.K.xxxx, vol.xx fq.xx, e llojit truall me sipërfaqe totale xxx m., e cila figuron në pronësi të shtetasit A., M. dhe F. H., të cilët e kanë blerë me kontratën e shitjes Nr.xxx Rep dhe Nr.xxx Kol. datë xxxx, me vlerë xxxx euro.
9. Pasurinë xxxx, Z.K.xxxx, vol.xx fq.xx, e llojit ndërtesë me sipërfaqe totale xx m., e cila figuron në pronësi të shtetasit A., M. dhe F. H., të cilët e kanë blerë me kontratën e shitjes Nr.xxx Rep dhe Nr.xxx Kol. datë xxxx, me vlerë xxxx euro.
10. Pasurinë xxxx, Z.K.xxxx, vol.xx fq.xxx, e llojit njësi me sipërfaqe totale xxx m., e cila figuron në pronësi të shtetasit F. H.; i cili e ka blerë me kontratën e shitjes Nr.xxx Rep dhe xxx Kol. datë xxxx, me vlerë xxxx euro.
11. Pasuria xxxx, Z.K.xxxx, vol.xx fq.xx, e llojit njësi me sipërfaqe totale xxx m., e cila figuron në pronësi të shoqërisë “xxxx” sh.a.;
12. Pasurinë xxxx, Z.K.xxxx, vol.xx fq.xxx, e llojit apartament me sipërfaqe totale xxx m., e cila figuron në pronësi të shtetasit Z. H., e cila e ka blerë me kontratën e shitjes Nr.xxx Rep dhe xxx Kol. datë xxxx, me vlerë xxxx (xxxx) lekë.
13. Një apartament me sipërfaqe xx m., ndodhur në lagjen “xxxx”, xxxx,

me vlerën xxxx euro. Nga dokumentacion i administruar rezulton se shtetasja K. H. (bashkëshortja e shtetasit A. H.), me kontratë paraprake shitje Nr.xxx Rep dhe Nr.xxx Kol. datë xxxx, ka blerë nga shoqëria “xxxx” sh.p.k.

14. Pasuria xxxx, Z.K.xxxx, vol.xx fq.xx, e llojit apartament, me sipërfaqe xxxx m., e cila figuron në pronësi të shtetasit F. M., i cili e ka blerë me kontratën e shitjes Nr.xxxx Rep dhe xxxx Kol. datë xxxx, me vlerë xxxx (xxxx) lekë.
15. Pasuritë e paluajtshme të shtetasit **A. C. H.** për të cilat ka aplikuar pranë Aluizni-t xxxx për legalizimin e objekteve sipas kërkesave: Nr.xxx datë xxxx, Nr.xxxx prot. datë xxxx dhe Nr.xxxx prot. datë xxxx.
16. Pasuritë e paluajtshme të shtetasit **M. C. H.** për të cilat ka aplikuar pranë Aluizni-t xxxx për legalizimin objekteve sipas kërkesave: Nr.xxxx datë xxxx, Nr.xxxx prot. datë xxxx dhe Nr.xxxx prot. datë xxxx.
17. Pasuritë e paluajtshme të shtetasit **F. C. H.**, për të cilat ka aplikuar pranë Aluizni-t xxxx për legalizimin objekteve sipas kërkesave: Nr.xxxx prot. datë xxxx, Nr.xxxx prot. datë xxxx dhe Nr.xxxx prot. datë xxxx.
18. Automjeti me targë -xxxx, e markës xxxx modeli xxxx, e vitit të prodhimit xxxx.
19. Automjeti me targë - xxxx, e markës xxxxx, e vitit të prodhimit xxxx.
20. Automjeti me targë - xxxxx, e markës xxxxx, e vitit të prodhimit xxxx.
21. Automjeti me targë - xxxxx, e markës xxxx, e vitit të prodhimit xxxx.
22. Automjeti me targë - xxxx, e markës xxxx, e vitit të prodhimit xxxx.

III. Pezullimin e pasojave të zbatimit të masës së sekuestrimit, të pasurive të sekuestruara me vendimin Nr.xxxx datë xxxxx, të Gjykatës së Shkallës së Parë xxxx, deri në dhënien e një vendimi gjyqësor penal për revokimin apo shuarjen e kësaj mase, për pasuritë si më poshtë:

1. Pasuria xxxx, Z.K.xxxx, vol.xxx fq.xxx, e llojit njësi me sipërfaqe totale xxx m., e ndodhur në lagjen “xxxx”, xxxx, e cila figuron në pronësi të shoqërisë “xxxxx” sh.a.
2. Pasuria xxxx, Z.K.xxxx, vol.xxx fq.xxx, e llojit njësi me sipërfaqe totale xxxx m., e ndodhur në lagjen “xxxx”, xxxx, e cila figuron në pronësi të shtetasit F. H..
3. Pasuria xxxx, Z.K.xxxx, vol.xx fq.xx, e llojit apartament me sipërfaqe totale xxxx m., e cila figuron në pronësi të shtetasit A. H..
4. Pasuria me sipërfaqe xxx m., apartament banimi në lagjen “xxxx”, xxxx, ndërtuar nga shoqëria “xxxx” sh.p.k. kontraktuar nga shtetasja K. H. në datë xxxxx.
5. Pasuria nr.xxxxx, me sipërfaqe xxxx m., e ndodhur në xxxx, Z.K.xxxx, vol.xx, fq.xx, në pronësi të shtetasit F. M..
6. Pasuria xxxx Z.K. xxxx, vol.xx fq.xx, e llojit ndërtesë me sipërfaqe xxx m., e ndodhur në lagjen “xxxx”, xxxx, e cila figuron në pronësi të shtetasit A. H..

IV. Për Administrimin dhe përdorimin e pasurive të luajtshme dhe paluajtshme

të ngarkohet Z.A. B. dhe E. R., administrator pranë Agjencisë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara pranë Ministrisë së Financave, Tiranë.

V. Për ekzekutimin e këtij vendimi të ngarkohet oficeri i policisë gjyqësore F. A., pranë Prokurorisë për Krime të Rënda Tiranë, i cili të dokumentojë veprimet e kryera.

VI. Urdhërohet sekretaria Gjyqësore e kësaj Gjykate t'i dërgojë menjëherë 2 (dy) kopje të këtij vendimi prokurorëve, Gentjan Osmani, Besim Hajdarmataj, Arens Çela, Dritan Prençi dhe Vladimir Mara.

VII. Kundër vendimit lejohet ankim brënda pesëmbëdhjetë ditëve, në Gjykatën e Apelit për Krimet të Rënda Tiranë, duke filluar nga dita e nesërme e shpalljes së këtij vendimi, dhe për palët nga e nesërmja e njoftimit, të këtij vendimi.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 15.09.2018, ora 11:30.

SEKRETARE

BLERTA MARTINI

GJYQTARE

IRENA GJOKA

